



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC



Njësia e personelit / Kadrovska Jedinica / Personnel Unit

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4375 Nr. i faq./Br.str./No.pg 141


Data/Datum/Date 01/7/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Për/Za/To: Z.Smajl Latifin, Kryetar i komunës së Rahovecit

Nga/Od/From: Agron Thaqi, U.D.Menaxher i personelit të komunës së Rahoveci

Lënda /Svrha/Subjekt/: **Raporti gjashtë mujor i punës për periudhën Janar-Qershor 2024**



I nderuar Kryetar.

Po iu prezantoj raportin gjashtë mujor të punës për periudhën Janar-Qershor 2024, të Njësise së Personelit, në komunën e Rahovecit.

1. REKRUTIMET

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 29 konkurse publike, prej të cilave 10 në shërbimin civil, 17 në Drejtorinë për Arsim si dhe 2 në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Të gjitha procedurat e shërbimit civil realizohen përmes programeve elektronike që është unike për Republikën e Kosovës.

Njësia e Personelit i shpall konkurset publike edhe për sektorin e arsimit dhe sektorin e shëndetësisë në programin elektronik: hrms.rks-gov.net.

Njësia e personelit gjatë këtyre 6 muajve është marrë edhe procedimin e të dhënave rreth propozimit për klasifikimin e punëtorëve në listat e pagave sipas ligjit të ri të pagave të cilët kanë mbetur pa u rregulluar, si dhe është duke u punuar në përpilimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në komunë.

2. PUSHIMET VJETORE

-Punëtorët janë duke shfrytëzuar ditët e mbetura të pushimit vjetor të vitit 2023, ku afati i fundit për shfrytëzimin e pjesës së dytë është data 31.06.2024.

3. LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE

-Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 45 shkresa administrative, si në vijim: Kontrata, vërtetime, vendime, draft vendime, propozim, akt emërimi, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa tjera si dhe ka dërguar mbi 150 emaile zyrtare.

4. MENAXHIMI I BURIMEVE NJËRËZORE SIPAS PROGRAMIT "HRMIS".

Në vazhdimësi Njësia e personelit menaxhon me programin elektronik HRMIS duke e populluar dhe freskuar me të dhëna këtë program sipas kërkesave që parashtrohet MPB-ja.

Ky program është i dizajnuar për menaxhimin elektronik të burimeve njerëzore dhe ka hyrë si prioritet i reformës së administratës shtetërore të Qeverisë së Kosovës.

5. PLANI INDIVIDUAL I PERSONELIT

Njësia e personelit ka hartuar draft Planin Individual të Personelit të komunës së Rahovecit për vitin 2024 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit hrms

Asnjë punësim në administratën komunale nuk mund të realizohet nëse pozitat nuk janë të përfshira në Planin Individual të Personeli.

6. ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE ELEKTRONIKE

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim: Menaxhon me programin elektronik hrms.rks.gov-net ku realizohen procedurat e rekrutimit.

Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punët të punëtorëve –pra programin SVP.

Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI- Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.

Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programit të listave pagave dhe pagesave të komunës.